

UDHËZIM
Nr.22, datë 9.4.2001

PËR CAKTIMIN E VËZHguesve PRANË QENDRAVE TË VOTIMIT DHE
KOMISIONEVE ZGJEDHORE

Në mbështetje të nenit 14, 15 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, udhëzon:

- Vëzhgues pranë qendrave të votimit dhe komisioneve zgjedhore mund të caktojnë organizatat joqeveritare shqiptare e të huaja të specializuara dhe të angazhuara në mbrojtjen e të drejtave të njeriut (më tej të quajtura “organizma”).

- Vëzhgues vendas mund të jetë çdo shtetas shqiptar që plotëson kushtet për të qenë zgjedhës (të jetë mbi 18 vjeç dhe të mos jetë shpallur me vendim gjykatë si i pazoti për të vepruar për shkak të paaftësisë mendore). Organizmi që kërkon të caktojë vëzhgues, përgjigjet për plotësimin e kushteve të mësipërme.

- Lista e personave që propozohen për vëzhgues nga një organizëm vendas, duhet të përmbajë adresën e organizmit që propozon vëzhgues, numrin e telefonit, informacione të tjera të dobishme për kontaktimin e subjektit dhe për çdo kandidat për vëzhgues të dhënat e mëposhtme:

EmriMbiemriDatëlindjaAtributi

(Afatgjatë, afatshkurtër)

- Lista për vëzhguesit vendas dorëzohet e shoqëruar nga dokumenti i regjistrimit të organizmit në gjykatë (fotokopje e noterizuar) dhe një kërkesë zyrtare, nënshkruar nga drejtuesi i organizmit.

- Vëzhguesit afatgjatë kanë të drejtë të vëzhgojnë procesin parazgjedhor si dhe atë paszgjedhor. Vëzhguesit afatshkurtër vëzhgojnë procesin vetëm ditën e votimit.

- Listat do të pranohen nga KQZ-ja jo më vonë se shtatë ditë para datës së zgjedhjeve.

- KQZ-ja miraton listat e vëzhguesve të paraqitura dhe pajis me autorizim të gjithë vëzhguesit, jo më vonë se 4 ditë para datës së zgjedhjeve.

- Vëzhguesit pajisen nga KQZ-ja me kartën e vëzhguesit dhe një autorizim të posaçëm. Organizmave u vihet në dispozicion një kopje e këtij udhëzimi dhe ata vetë ua bëjnë të njohur vëzhguesve të tyre.

- Vëzhguesit janë të detyruar të respektojnë kërkesat e “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” dhe udhëzimet e nxjerra nga KQZ-ja lidhur me vëzhgimin e zgjedhjeve. Ata duhet të veprojnë në mënyrë të paanshme, të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat apo parti në qendrat e votimit ose vende të tjera të ndaluara nga “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe të mos mbajnë shenja dalluese që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësve. Atyre u ndalohej të ndërhyjnë në veprimtarinë e komisioneve zgjedhore.

- Në rast se KZZ-të ose KQV-të konstatojnë parregullsi në veprimtarinë e vëzhguesve, ato denoncojnë faktin pranë KQZ-së, i cili nga ana e vet ka të drejtë deri të anullojë akreditimin.

- Vëzhguesit bëjnë pjesë në personat që mund të qëndrojnë në qendrën e votimit. Ata paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja si dhe një dokument identifikimi. Pasi vëzhguesit afatshkurtër (vëzhgues pranë Qendrave të Votimit) i paraqesin KQV-së autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja, KQV-ja shënon në autorizim numrin e QV-së dhe zonën zgjedhore përkatëse, si dhe shënon në procesverbal emrin e vëzhguesit dhe të organizmit të tij, duke bërë kujdes që nga i njëjti organizëm të mos ketë më shumë se dy vëzhgues njëkohësisht për qendër votimi.

- Vëzhguesit, gjatë kryerjes së detyrave të tyre kanë të drejtë të vëzhgojnë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të paraqesin vërejtje me shkrim për çdo lloj parregullsie që vërejnë.

- Vëzhguesit kanë të drejtë të qëndrojnë në qendrën e votimit edhe pas përfundimit të votimit për të vëzhguar procesin e numërimit të votave dhe deri në shpalljen e rezultateve. Ata pajisen, sipas kërkesës së tyre, edhe me një kopje të tabelës së rezultateve të qendrës së votimit.

- Përkthyesit e vëzhguesve të huaj pajisen me dokumentin përkatës, sipas kërkesës së organizmit ndërkombëtar. Përkthyesit mund të shoqërojnë vëzhguesit e huaj në ambientet që “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” ua lejon vëzhguesve, por në asnjë rast ata nuk mund të hyjnë aty vetëm.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi